



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:197672

Datë: 28.07.2023

Numri i dokumentit: 04532591

K.nr.312/22.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Dega në Klinë-Divizioni për Kundërvajtje në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Benita Company SH.P.K. si person juridik me seli në fshatin Gremnik K. e Klinës i përfaqësuar nga juristi i firmës Besard Elezaj, për kundërvajtje nga neni 15 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme, në bazë të nenit 55,86,124 dhe 127 të Ligjit për Kundërvajtje (LK) me dt.27.07.2023 merr:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

„Benita Company,, Sh.p.k. si person juridik me seli në fshatin Gremnik K. e Klinës i përfaqësuar nga zyrtari ligjor Besard Elezaj, me veprimtari sekondare shitja dhe deponimi i derivateve të naftës për qëllime afariste, me nr. unik identifikues 810313213, më parë i pa dënuar për këtë kundërvajtje.

Është përgjegjës

Sepse:

Si Operatorë Ekonomik i licencuar për shitjen me pakicë dhe shumicë të derivateve të naftës, nga data 01.09.2022 e deri më 08.09.2022 në pikën e karburantit Benita Company me veprimtari në fshatin Gremnik K. e Klinës nuk kishte ushtruar mbikëqyrjen e duhur ndaj punëtorëve përgjegjës me qëllim të zbatimit të Vendimit nr.01/132 të datës 30.08.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve nga lëvizjet e mëdha të çmimeve dhe eliminimit të çrregullimeve në treg me naftë dhe derivate të naftës, në arë mënyrë që me rastin e inspektimit nga ana e Inspektorëve të Tregut të MINT në bashkëpunim me Inspektorët e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe verifikimit të çmimeve të shitjes të karburanteve me pakicë dhe shumicë përmes krahasimit të faturave të shitjes dhe çmimit të kostos së karburantit, ka rezultuar se e ka tejkaluar marzhën tregtare të shitjes për produktin e naftës (Dizel) me shumicë 0.02 eurocentë për litër, në atë mënyrë që mesatarja e ndryshimit për periudhën e lartë cekur ka rezultuar 0.05 cent për litër.

Numri i lëndës: 2022:197672
Datë: 28.07.2023
Numri i dokumentit: 04532591

Me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 15 par.2 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme andaj, në bazë të nenit 19 par.13 par.1 të ligjit të lartë cekur:

D Ë N O H E T

ME DËNIM NË TË HOLLA në shumë prej 2.000€ / dymijë euro /
Dënimin e shqiptuar në të holla ka për ta paguar në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën gjoha do të inkasohet detyrimisht konform Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Në të njëjtin afat obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale paushalle të paguaj shumën prej 15€ /pesëmbëdhjetë euro/ nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Inspektorati i MINT ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje me nr.Ref.19/2022 të datës 21.09.2022 kundër të pandehurit „Benita Company,, Sh.p.k si person juridik duke kërkuar që të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas dispozitave ligjore nga neni 15 lidhur me nenin 19 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme

Gjyqtari pasi filloi procedurën për kundërvajtje mori në pyetje përfaqësuesin me autorizim të pandehurës-zyrtarin ligjorë-Besard Elezaj i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar se e kundërshton kërkesën për kundërvajtje si të pa bazuar me arsyetim se Benita Company nuk e ka tejkaluar çmimin maksimal të lejuar me vendimin përkatës të Qeverisë së Kosovës, ngase me rastin e kalkulimit të çmimit nga ana e inspektorëve të ATK-së nuk janë kalkuluar një mori shpenzimesh si: shpenzimet e akcizës, shpeditacionit, terminalit, shpenzimet e transportit, taksa rrugore, paga e shoferit... ashtu që nëse çmimit furnizues do ti shtoheshin edhe shpenzimet e lartë cekura do të rezultojë se nuk është tejkaluar çmimi maksimal 0.02 cent, dhe si dëshmi i ka prezantuar gjykatës Deklaratën Unike Doganore, shpenzimet për akcizë, shpeditacion, fatura e shpenzimeve të derivateve si dhe një mori shpenzimesh tjera.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit inspektorin e rastit Eljesa Beqiri i cili ka dëshmuar se ditën kritike së bashku me kolegen Fexhrije Salihu dhe në bashkëpunim me Inspektorët ve Administratës Tatimore të Kosovës kishin qenë në kontroll në pikën e karburantit në fjalë dhe kanë konstatuar se nuk ishte duke u respektuar Udhëzimi Administrativ nr.09/2022 për plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr.03/2022 për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës, respektivisht kishin konstatuar se e pandehura e kishte tejkaluar çmimin maksimal të lejuar të shitjes me shumicë të produktit Dizel në atë mënyrë që ishte tejkaluar çmimi maksimal 0.02 cent i marzhës tregtare, dhe si dëshmi kërkesës i kishin bashkangjitur përlllogaritjen në formë tabelare, ndërsa për pretendimin e përfaqësuesit të pandehurës se nuk janë llogaritur edhe shpenzimet e shumta që firma i ka me rastin e transportit të naftës nga Shqipëria, dëshmitari ka deklaruar se kjo nuk e liron të pandehurën nga përgjegjësia ngase i kishin pasur parasysh paraprakisht të gjitha këto shpenzime dhe pas përlllogaritjes me përkushtim të çmimit hyrës të derivateve në fjalë nga Dogana e Kosovës, kishin ardhur në përfundim se marzha tregtare ishte tejkaluar mbi 0.02 cent si në tabelën e bashkangjitur kërkesës.

Numri i lëndës: 2022:197672
Datë: 28.07.2023
Numri i dokumentit: 04532591

Në cilësi të provës materiale gjykata ka shikuar, lexuar dhe analizuar procesverbalin e Inspektoratit të Tregut mbi inspektimin e bërë me nr.00693 të datës 08.09.2022, Vendimin e Qeverisë së Kosovës Ref. Nr.01/132 të datës 30.08.2022, formën shkresore për vizitat përmbush të ATK-së të datës 15.09.2022 nga inspektorët tatimorë Valon Demaj dhe Safet Dragusha si dhe rezultatet e paraqitura në formë tabelare nga inspektorët tatimorë të lartë cekur.

Gjykata pas vlerësimit të kërkesës për fillimin e procedurës për kundërvajtje, deklaratës së përfaqësuesit të personit juridik, dëshmisë së inspektorit të rastit Eljesa Beqiri, procesverbalit mbi kryerjen e mbikëqyrjes shkresat tjera bashkangjitur shkresave të lëndës në cilësi të provave materiale gjen se i pandehuri është kryes i kundërvajtjes e cila i vihet në barrë.

Pretendimet e përfaqësuesit se nuk janë llogaritur edhe shpenzimet tjera në çmimin hyrës gjykata i ka vlerësuar si të pa bazuara ngase janë në kundërshtim me dëshminë e inspektorit të rastit i cili ka dëshmuar se të njëjtat janë llogaritur paraprakisht me përkushtim edhe nga Dogana e Kosovës dhe rezultatet janë paraqitur në formë tabelare dhe janë argumentuar detalisht, andaj deklarata e inspektorit të rastit është vlerësuar nga gjykata si plotësisht e besueshme ngase ai në detyrë zyrtare dhe në bazë të përlllogaritjeve të Inspektorëve Tatimorë të ATK-së ka konstatuar kundërvajtjen të cilën ia ka vënë në barrë të pandehurit dhe në mënyrë të qartë, precize, argumentuese dhe të pa dyshimtë ka vërtetuar thëniet nga kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse andaj deklaratës së të njëjtit gjykata nuk pati asnjë arsye të mos ia falë besimin ngase edhe gjatë procedurës është vërtetuar se nuk ka asgjë personale me të pandehurin.

Me rastin e përcaktimit për lartësinë e gjobës gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 31 të LK-së, mesin e të cilave rrethana rënduese nuk ka gjetur, ndërsa si lehtësuese është vlerësuar fakti se sipas sistemit SMIL të gjykatës nuk kemi gjetur se i njëjti është dënuar për këtë kundërvajtje dy vitet e fundit kështu që gjykata ka krijuar bindje se edhe me shqiptimin e gjobës minimale të paraparë mund të arrihet qëllimi preventiv i sanksionit.

Meqë i pandehuri është shpallur përgjegjës për kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, i njëjti konform nenit 59 Ligjit për Kundërvajtje ngarkohet me shpenzimet paushalle të procedurës.

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë-Divizioni për Kundërvajtje.
K.nr.312/22. Dt.27.07.2023

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit nëpërmes kësaj gjykate në afat prej 8 ditësh pas pranimit të aktgjykimit.



Gjyqtari,
Feti Gashi

REPUBLIKA E KOSOVES
VENDIMI ËSHTË I PLOTËQJENËM
OBLUKA JE PRAVNO SNAJNA
GJYKATA THEMELORE I OSNOVNI
PEJË II PEÇ

Nr. 08. 23